

Programi i Unionit Evropian "IPA II" për "Kosovën"

Produkti D1.4.2

Raporti i Analizës dhe Rekomandimet

"Lëvizja Përpara:

Promovimi i efikasiteit dhe efektivitetit më të
madh në luftë kundër Trafikimit të Qenieve
Njerëzore në Kosovë"



Projekt i Financuar nga BE dhe i menaxhuar nga zyra e
BE në Kosovë



Projekt i implemtuar nga
Family and Childcare Centre
(KMOP)



Kontrata Nr:
2016/382-826

Raporti i Analizës dhe Rekomandimet



INSTRUMENTI PËR ASISTENCË PARA PRANIMIT (IPA II)
Vija Buxhetore: BGUE-B2014-22.020101-C1-ELARG DELKOS
Referenca: EuropeAid/150787/DD/ACT/XK

**“LËVIZJA PËRPARA: PROMOVIMI I EFIKASITETIT DHE
EFEKTIVITETIT MË TË MADH NË LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT
ME QENIE NJERËZORE NË KOSOVË”**

NUMRI I KONTRATËS: 2016/382-826

Produkti D1.4.2

Raporti i Analizës dhe rekomandimet

Informata mbi dokumentin

Data e caktuar e dorëzimit	31/07/2017
Data e dorëzimit aktual	31/07/2017
Emri i organizatës dhe kontraktorit Lider për këtë produkt	EPLO
Revizioni	2.0

Niveli i shpërndarjes

PU	Publik	X
PP	I Kufizuar për pjesëmarrësit e programit (përfshirë shërbimet e komisionit)	
RE	I Kufizuar për grupin e specifikuar nga Konzorciumi (përfshirë shërbimet e komisionit)	
CO	Konfidencial, vetëm për anëtarët e konzorciumit (përfshirë shërbimet e komisionit)	

Lista e Autorve	
Autori	Partneri
Vasiliki Artinopoulou	EPLO
Alexandra Koufouli	EPLO
Iro Michael	EPLO
Rishikuesit	
Rishikuesi	Partneri
Antonia Torrens	KMOP
Vassia Karkantzou	KMOP
Hamijet Dedolli	PVPT
Floriana Ferri	PVPT
Versioni	
Versioni	Përmbledhja
1.0	Zhvillimi i draftit versioni v01
2.0	Versioni Final

Projekti është i financuar me përkrahjen me e Komisionit Evropian.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si reflektim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	4
LISTA E SHKURTESAVE	5
Hyrje	6
Informata përcjellëse	7
Qëllimi dhe përmbajtja e raportit të Analizës & Rekomandimeve	7
1. Aspektet Ligjore dhe Rekomandimet	9
1.1 E drejta për aplikim të ri dhe rishqyrtim të aplikacioneve.....	9
1.2 Afati kohor i aplikimit.....	9
1.3 Shuma maksimale për kompensim	10
1.4 Trajtimi i aplikacioneve për kompensim për humbjen e të afërmit	10
1.5 Shpenzimet mjekësore	11
1.6 Rrethanat që ndikojnë në kompensim.....	11
1.7 Ankesat Administrative.....	12
1.8 Afatet kohore për rastet ndër-kufitare.....	12
2. Kompensimi i Viktimave të Trafikimit	12
3. Aspektet vepruese dhe Rekomandimet.....	14
3.1 Procedurat Standarde të Veprimit.....	14
3.2 Sistemimi i vendim-marrjes.....	15
3.3 Sistemi i mbrojtjes së të dhënave dhe regjistrave	16
3.4 Pengesat Potenciale	16
3.5 Forma e aplikimit	17
3.6 Ofrimi i informatave për aplikuesit	17
3.7 Kooperimi institucional dhe dukshmëria e Programit.....	18
Vërejtjet & Rekomandimet konkluduese	18
Rekomandimet për ofrimin e përkrahjes për Komisionin dhe Sekretariatn.....	20

LISTA E SHKURTESAVE

Lista e Shkurtesave	
AU (QRK) Nr 01/2017	Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 01/2017 për Mënyrën e Kompensimit duke përfshirë Llogaritjen e Kompensimit për Dëmtimet e Shumëfishta. Miratuar në mbledhjen e 127 të Qeverisë së Kosovës, me vendimin Nr. 01/127, të datës 13.01.2017.
UA (QRK) Nr 02/2017	Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 02/2017 Mbi Regjistrat për Aplikuesit dhe Vendimet e Lëshuara mbi Kompensimet. Miratuar në mbledhjen e 127 të Qeverisë së Kosovës, me vendimin Nr. 02/127, të datës 13.01.2017.
Ligji Nr. 04/L-218	Ligji Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit Aprovuar nga Kuvendi, me datën 31.07.2013, dhe shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, Nr. DL-43-2013, të datës 19.08.2013
Ligji Nr. 05/L-036	Ligji Nr. 05 / L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit Miratuar nga Kuvendi, me datën 28.05.2015, dhe shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. DL-009-2015, të dates 15.06.2015

Hyrje

Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një analizë të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse mbi funksionin e Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, më poshtë i referuar si 'Komisioni'¹, i cili është krijuar kohët e fundit për shqyrtimin e kërkesave për kompensim në kontekstin e Programit për Kompensimin e Viktimës së Krimit Programi në Kosovë.

Ky raport i analizës dhe rekomandimeve është zhvilluar në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja "Lëvizja përpara - Promovimi i efikasitetit dhe efektivitetit më të madh në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë" i zbatuar nga Qendra për Kujdes të Familjes dhe Fëmijës (KMOP) në bashkëpunim me Organizatën Evropiane të Ligjit Publik EPLD (GR) dhe Qendrën për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (PVPT) në Kosovë (financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë). Projekti filloi në Janar 2017 dhe do të zgjasë deri në Janar 2020 me objektivin e përgjithshëm për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore (TQNj) në Kosovë duke rritur aftësinë e institucioneve të Kosovës për të koordinuar dhe zbatuar në mënyrë efektive të gjitha masat kundër -TQNj, në përputhje me praktikën më të mira të legjislativimit të BE-së dhe prioritetet e përgjithshme të zhvillimit të Kosovës.

Ky raport përcjell zhvillimin e Manualit (Produkti D1.4.1.) duke detalizuar aspektet operative të Komisionit dhe përbën një pjesë të aktiviteteve të projektit që mbështesin ngritjen e një sistemi të integruar të kompensimit të viktimave në Kosovë, i zhvilluar në kontekstin e veprimeve të ndihmës teknike të projektit. Megjithatë Programi i Kompensimit të Viktimave parashih kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në viktimat e trafikimit, këto të fundit pritet të jenë një nga përfituesit kryesorë të Programit. Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-218 "Për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit", viktimat e trafikimit kanë të drejtën e kompensimit të shtetit në rastet kur kompensimi nga kryerësit është i pamundshëm ose nëse autorët e krimit nuk janë identifikuar, ndjekur penalisht ose nuk janë dënuar. Prandaj bëhet siguri i një të drejte tjetër të arritshme për viktimat e tilla.

¹ Termat 'Komiteti' dhe 'Komisioni' janë përdorur në mënyrë të ndërsjellë kur i referohet Programit të Kompensimit të Viktimave. Për shembull, Ligji Nr. 05/L-036 Për Kompensimin e Viktimave të Krimit i referohet një 'Komiteti', ndërsa UA (QRK) Nr. 01/2017 dhe UA (QRK) Nr. 02/2017 i referohen të njëjtit institucion si 'Komisioni'. Termi "Komision" u miratua dhe u përdor gjatë përkthimit të këtij raporti, në përputhje me përkufizimin përkatës të Udhëzimeve Administrative të Qeverisë dhe përdorimit të këtij përkufizimi gjatë takimeve me zyrtarë të institucioneve anëtare të Programit të Kompensimit të Viktimave.

Informata përcjellëse

E drejta e viktimave për kompensim është themeluar në Kodin e Procedurës Penale të vitit 2013. Ligji Nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimin, themelimi dhe detajimi i funksionimit të Programit të Kompensimit të Viktimave të Krimin, u miratua në maj të vitit 2015 dhe nenet që rregullojnë kompensimi i viktimave hyri në fuqi një vit më vonë, në maj 2016.

Për më tepër, në Janar 2017 janë nxjerrë dy Udhëzime Administrative (UA) që detajojnë më tej veprimet e saj. UA (QRK) Nr. 01/2017 përcakton mënyrën e dhënies së kompensimit, duke përfshirë aplikimin, llogaritjen dhe proceset e vendimmarrjes dhe AU (QRK) Nr 02/2017 rregullon formën dhe mënyrën e mbajtjes së të dhënave për të gjitha kërkesat dhe vendimet për kompensim. Formularët përkatës të aplikimit dhe udhëzimet për aplikuesit për kompensim u lëshuan nga Ministria e Drejtësisë më 11 Maj 2017. Më pas, një Sekretariat që siguron mbështetjen e nevojshme administrative dhe teknike për veprimet e Komisionit u themelua më 24 Maj 2017.

Periudha e shkurtër kohore që nga fillimi i Programit, në kohën e shkrimit të këtij raporti në Korrik 2017, asnjë kërkesë për kompensim ende nuk është dorëzuar ose shqyrtuar nga Komisioni.

Qëllimi dhe Përmbajtja e Raportit të Analizës & Rekomandimeve

Për qëllime të raportit aktual, hulumtimi në vend pune dhe analiza ligjore e dokumenteve relevante legjislative u zhvillua gjatë muajve Maj dhe Qershor 2017. Përveç kësaj, përmbajtja e raportit është zhvilluar në bazë dhe në përputhje me kontributin e autoriteteve përkatëse dhe statusin aktual të veprimeve të Programit të Kompensimit të Viktimave të parashikuara në Korrik 2017 nga Ministria e Drejtësisë.

Në kohën e shkrimit të këtij raporti në Korrik 2017, asnjë kërkesë për kompensim ende nuk është dorëzuar ose shqyrtuar nga Komiteti, kështu që ky raport nuk mund të bazohet në prova empirike.

Hulumtimet dhe analizat e ndërmarra në procesin e analizimit të legjislacionit ekzistues për qëllimet e Manualit të zhvilluara në kuadrin e projektit ishin kritike në identifikimin e çështjeve kyçe që mund të përfitoheshin nga shqyrtimi i mëtejshëm dhe qasja kritike. Analiza përkatëse ka identifikuar çështjet e mundshme vepruese dhe ligjore, barrierat dhe pengesat që potencialisht mund të operacionalizohen më tej.

Çështjet kyçe janë të ndara gjerësisht në dy kategori themelore: aspektet operacionale dhe ligjore. Të më vonshmet janë të lidhura kryesisht me dispozitat që mund të përfitojnë nga sqarime të mëtejshme në mënyrë që niveli i sigurisë juridike të rritet dhe që zbatimi uniform i kuadrit ligjor ekzistues të jetë i arritshëm. E para është kryesisht e lidhur me aspektet operacionale të kornizës së

Kompensimit të Viktimave të Krimin, të cilat potencialisht mund të kontribuojnë në zgjerimin e veprimeve të Komitetit.

Në ndërkohë, vërehen shqetësime lidhur me zbatimin e kornizës ligjore për viktimat e trafikimit. Në përputhje me qëllimet e projektit dhe duke marrë parasysh shtrirjen më të gjerë të punëve të Komisionit - p.sh. kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar, viktimat e trafikimit - vëmendje e veçantë i është kushtuar rishikimit të kornizës ekzistuese nga këndi i viktimave të trafikimit, të cilët pritet të përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të përfituesve potencial. Në këtë rast është identifikuar një rrezik potencial që viktimat e tilla në praktikë duhet të zgjedhin midis të drejtës së tyre për sigurinë ose të drejtën e tyre për kompensim.

Duke ndjekur identifikimin dhe analizën e lartpërmendur, një sërë sugjerimesh dhe rekomandimesh janë paraqitur në pjesën e fundit të raportit. Ndër të tjera, vërejtjet përmbyllëse të raportit identifikojnë dhe ofrojnë rekomandime për fushat kyçe për ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimin për Komisionin dhe Sekretariatit i cili, bazuar në gjetjet e raportit aktual, mund të kontribuojë në funksionalizimin e mëtejshëm të tyre. Duhet të theksohet se meqë qëllimi i Programit të Kompensimit të Viktimave është të mbështesë viktimat e krimeve në përgjithësi, dhe jo vetëm viktimat e trafikimit, krijimi i sinergjive të nevojshme me përpjekjet paralele të bëra në terren mbetet thelbësor.

1. Aspektet Ligjore dhe Rekomandimet

Analiza funksionale e legjislacionit ekzistues solli një numër çështjesh ose detajesh, të cilat potencialisht mund të krijojnë paqartësi në zbatimin ose interpretimin e dispozitave ekzistuese dhe/ose hapësirën për bllokimin e veprimtarisë. Ajo që vijon është një përshkrim i shkurtër i secilës çështje dhe kërcënimeve të mundshme që mund të lindin, pasuar nga veprimet e rekomanduara.

1.1 E drejta për aplikim të ri dhe rishqyrtimi i aplikacioneve

Nëse nuk parashikohet ndryshe në një dispozitë tjetër ligjore, është e paqartë sipas Ligjit Nr. 05/L-036 nëse aplikantëve u jepet e drejta për një aplikim të ri apo rishqyrtimin e aplikacionit të tyre fillestar kur është marrë vendim mbi aplikacionin origjinal. Kjo konsideratë është e rëndësishme në rastet kur pas vendimit mbi një aplikacion janë marrë dëshmi të reja ose dokumente mbështetëse ose janë paraqitur kërkesa të reja për dëmshpërblim.

Në mënyrë të ngjashme, në rastet e aplikacioneve të pakompletuara ose të pakuptueshme, aplikuesit mund ti kërkohej dokumentacion shtesë, dhe kërkesa e tij/saj mund të refuzohet për shkak të mosparaqitjes së dokumentacionit në fjalë brenda afatit të përcaktuar kohorë (neni 33, §2,/L-036). Në këtë rast, është gjithashtu e paqartë nëse aplikuesit kanë apo duhet të kenë të drejtën për një aplikim të ri ose për të rishqyrtuar aplikacionin e tyre fillestar, nëse informatat ose dokumentet në dispozicion u bënë të njohura ose të disponueshme pas skadimit të afatit të caktuar. Kjo mund të dëshmohej si e dobishme nëse këto çështje janë marrë në konsideratë nga autoritetet dhe në përputhje me rrethanat legjislacioni është sqaruar dhe plotësuar.

1.2 Afatet kohore të aplikimit

Aplikantët që kërkojnë qasje të menjëhershme ndaj kompensimit të viktimës sipas Nenit 9 Ligji Nr. 05/L-036 duhet të paraqesin aplikacionet e tyre jo më vonë se 6 muaj pas kryerjes së veprës së fundit sipas Nenit 31, § 1, të njëjtit ligj. Megjithatë, dhe sipas dispozitës së Nenit 9 § 1, ata nuk mund të paraqesin një aplikacion të tillë para se të kalojnë tre muaj nga zbulimi ose raportimi i krimin. Në mënyrë efektive, afati i fundit në raste të tilla reduktohet në 3 muaj dhe në disa raste nuk fillon para afatit të përcaktuar në Nenin 9 §1. Mund të ketë raste kur kjo periudhë mund të jetë e papërshtatshme.

Për shembull, në rastin e viktimave të trafikimit, të cilët sipas dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-218 dhe për shkaqe që lidhen me sigurinë e tyre mund të vendosen jashtë vendit ose mund të kenë kufizime kur të japin të dhënat e tyre personale për një periudhë të caktuar kohe. Në mënyrë të ngjashme, viktimat e tilla të veprave penale kanë të drejtën për një periudhë reflektimi që mund të zgjasë deri në 90 ditë (Neni 20, §2.9, Ligji Nr. 04/L-218) gjatë së cilës ata mund të vendosin nëse do të bashkëpunojnë me autoritetet Neni 38, pika 6, ligji nr. 04/L-218). Prandaj është e mundur që këto

viktima të përfundojnë pa të drejtë kompensimi, për shkak të afatit të kufizuar të aplikimit të parashikuar nga ligji. Gjithashtu, e drejta e tyre mund të kufizohet për shkak të kohës së limituar për përmbushjen e parakushtit kryesor për qasje të menjëhershme në kompensim, detyrimin e tyre për bashkëpunim të arsyeshëm në hetimin dhe ndjekjen penale të kryerësit të krimit (neni 9, pika 2, L-036).

Zbatimi i dispozitës së lartpërmendur mund të jetë praktikisht problematike, veçanërisht pasi që viktimat e krimeve të ndërlidhura me trafikim janë ndër viktimat që mund të përfitojnë nga këto lloje të kompensimit. Prandaj është e këshillueshme që dispozitat e përmendura të rishikohen në këtë fushë. Më e rëndësishmja, do të ishte e dobishme të shqyrtojmë nëse afati efektiv 3-mujor duhet të zgjerohet ose të definohet në mënyrë tjetër (shih gjithashtu seksionin 2.2).

1.3 Shuma maksimale e kompensimit

Neni 14 §3, UA (QRK) Nr. 01/2017 mund të shihet si i paqartë për çështjen e shumës maksimale të kompensimit për dhimbjet fizike ose dëmtimet që do të jepen sipas Nenit 13 Ligji Nr. 05/L-036. Termi "maksimumi i kompensimit të parashikuar kumulativisht për të gjitha dëmtimet e parashikuara në nenin 13 të Ligjit" mund të interpretohet si referencë ndaj pragut të përcaktuar në Nenin 13 §3 (7,000 euro) dhe si një shumë e përbërë nga shuma e pragjeve të përcaktuara në §1, 2, 3 të të njëjtit Nen, përkatësisht 11.500 euro. Është e qartë në aplikacionin për Kompensim që u ofrohet aplikuesve se shteti zgjedh interpretimin e mëparshëm. Megjithatë, kjo mund të dëshmohet si e dobishme dhe mosmarrëveshjet e ardhshme ligjore mund të shmangen nëse çështja sqarohet më tej në Nenin. 14 § 3 i UA (QRK) Nr. 01/2017.

1.4 Trajtimi i aplikacioneve për kompensim për humbjen e të afërmit

Neni 20 UA (QRK) Nr. 01/2017 në përgjithësi i referohet Neneve 15 dhe 16 për çështjen e një viktime jo të drejtpërdrejtë të një krimi që pretendon kompensim për humbjen e një të afërmi të ngushtë. Megjithatë, një referencë e drejtpërdrejtë bëhet vetëm për përjashtimin e dokumentacionit të Nenit 16, §2. Kjo dispozitë i referohet "kategorive të veçanta ose viktimave". Me zbatimin e kësaj dispozite, Komisioni mund të hasë vështirësi në vendosjen nëse një aplikacion sipas Nenit 20 UA (QRK) Nr. 01/2017 duhet të trajtohet proceduralisht dhe substancialisht në të njëjtën mënyrë si një aplikim i "viktimave të kategorisë së posaçme" ose nëse konsideratat e tjera të përcaktuara në Nenin 15 janë gjithashtu relevante. Kjo mund të dëshmohet si e dobishme nëse Neni 20 UA (QRK) Nr. 01/2017 është rishikuar në kuadër të kësaj fushe praktike, në mënyrë që të shmangen mospërputhjet e mundshme të zbatimit për çështje të tilla si dokumentacioni i nevojshëm që mbështet një aplikim, shuma e kompensimit etj.

1.5 Shpenzimet mjekësore

Sipas Nenit 16 Ligji nr. 05/L-036 "E drejta e kompensimit për shpenzimet mjekësore dhe hospitalizim duhet të njihet dhe të llogaritet në përputhje me listën e çmimeve të shërbimeve mjekësore nën sistemin e kujdesit shëndetësor publik të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë". Kjo dispozitë nuk duhet të kuptohet në atë mënyrë që i lejon viktimës të mos ketë të drejtën e kompensimit për një shpenzim mjekësor dhe spitalor, në rast se ky shpenzim i veçantë nuk është për ndonjë arsye i përfshirë në listën e çmimeve të shërbimeve mjekësore në Ministrinë e Shëndetësisë. Në këtë drejtim, Neni 15 § 5, UA (QRK) Nr. 01/2017 përcakton si ndihmë listën e lartpërmendur si udhërrëfyes, dhe jo një katalog ekskluziv të shpenzimeve të mundshme që një aplikant mund të kërkojë.

1.6 Rrethanat që ndikojnë në kompensim

Neni 20, §1, Ligji Nr. 05/L-036 parashtron arsyet në të cilat kompensimi mund të refuzohet ose shumën e kompensueshme mund të reduktohet. Disa nga shprehjet e përdorura (të tilla si "për shkak të sjelljes së viktimës para, gjatë ose pas krimit" ose "ndjenjën e drejtësisë") janë mjaft të përgjithshme dhe të gjera, siç pritet nga një dispozitë Ligjore. Megjithatë, meqenëse interpretimi i këtyre termave është kritik, mund të ngriten dy rreziqe:

- zbatimi i dispozitës mund të dëshmohej në praktikë të jetë jo uniform, duke rezultuar në vendime të ndryshme të Komisionit lidhur me rastet e ngjashme apo të krahasueshme;
- kompensimi mund të mohohet ose zvogëlohet në bazë të meritave që janë prima facie të parëndësishme me specifikat e rastit në fjalë, si "sjellja jo etike e viktimave" ose "rendi publik";

Disa udhëzime mbi zbatimin e atyre më sipër ofrohen vetëm në lidhje me sjelljet e viktimës së vdekur para krimit, ku sipas Nenit 11, § 3 i UA (QRK) Nr. 01/2017: "E kaluara e të vdekurit do të konsiderohet vetëm nëse viktima është përfshirë në vepra të rënda penale që do të bënin kompensimin një shkelje të ndjenjës së drejtësisë ose rendit publik, ose do të ishte përdorim i padrejtë i fondeve publike".

Në këtë drejtim, mund të jetë e dobishme që UA (QRK) Nr. 01/2017 ofroi më shumë udhëzime konkrete për zbatimin e Nenit 20, §1, Ligji Nr. 05 / L-036. Për këtë qëllim, shqyrtimi i praktikës ekzistuese të gjykatave mund të dëshmohej si i dobishëm.

Përveç kësaj, duke pasur parasysh ngjashmëritë ndërmjet dispozitës së këtij Neni dhe Nenit 8 të "Konventës Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme" të vitit 1983, Raporti shpjegues pasues i Traktatit, dhe më konkretisht paragrafët 33 deri në 37, mund të shërbejnë si udhëzim i përgjithshëm drejt interpretimit të këtyre Neneve, duke siguruar një përputhje dhe saktësi zbatimi.

1.7 Ankesat Administrative

Neni 34, § 7, Ligji Nr. 05/L-036 thekson se ankuesi ka të drejtën të fillojë një ankesë administrative kundër vendimit të Komisionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Njohja e legjislacionit në fuqi, veçanërisht në lidhje me ankesat administrative, mund të jetë një çështje komplekse për cilindo person, veçanërisht për një person që nuk ka arsimim ligjor. Do të ishte një praktikë e mirë nëse legjislacioni i zbatueshëm dhe mjetet ligjore të disponueshme ti jenë të njohura paraprakisht një aplikuesi. Nëse autoritetet nuk e konsiderojnë të nevojshme përfshirjen e informative të tilla në UA (QRK) Nr. 01/2017, do të ishte një praktikë e mirë që një informatë e tillë dhe detajet mbi procesin e aplikueshëm të përfshihen në njoftimin e dërguar aplikantit, së bashku me vendimin e Komisionit.

1.8 Afatet kohore në rastet ndër-kufitare

Neni 27, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017 thekson se në rastin e një situatë të huaj ndër-kufitare, Ministria e Drejtësisë do të shqyrtojë kërkesën dhe brenda 60 ditëve informon aplikuesin nëse aplikacioni i tij/saj është i mundur dhe i pranueshëm sipas ligjeve të shtetit ku është kryer vepra penale. Megjithatë, në §3 të të njëjtit Nen thuhet se nëse kompensimi nuk është i mundur sipas ligjeve të shtetit në fjalë, aplikanti do të njoftohet brenda 30 ditëve nga marrja e informatës. Gjithashtu, §4 parashikon që nëse aplikimi i tillë i kompensimit është i pranueshëm në shtetin në fjalë, aplikanti do të njoftohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Në këtë pikë, është e paqartë se cili afat është i aplikueshëm dhe nëse afatet e lartpërmendura duhet të interpretohen si plotësues për njëri-tjetrin (shembull: 60 ditë brenda pranimit të një aplikacioni ose 30 ditë pas pranimit të informatave nga Shteti i huaj, cilado që është më e favorshme për aplikantin). Interpretimi dhe zbatimi i këtyre dispozitave mund të jetë kritike, veçanërisht në kontekstin e ankesave të mundshme administrative. Kështu, mund të jetë e dobishme nëse Neni 27, §2, 3, & 4, UA (QRK) Nr. 01/2017 të jetë shqyrtuar dhe ndryshuar, nëse është e nevojshme, në mënyrë që të mënjanojnë mospërputhjet interpretuese.

Për më shumë, Neni 27, § 4, 10 UA (QRK) Nr. 01/2017 deklaron se aplikanti duhet të informohet "sa më shpejt që të jetë e mundur". Në shumicën e rasteve, UA e njëjtë përcakton një periudhë të caktuar kohore (zakonisht 60 ditë) brenda së cilës duhet të bëhet njoftimi për aplikantin. Nëse nuk ka ndonjë ngjarje specifike në lidhje me rrethanat e jashtëzakonshme të përcaktuara në Nenin 27, § 4, 10 UA (QRK) Nr. 01/2017, mund të jetë një praktikë më e mirë të caktohet një afat specifik kohorë.

2. Kompensimi i viktimave të trafikimit

Ligji Nr. 05/L-036 është i zbatueshëm në shumë raste të krimeve që konsiderohen të dhunshme, por pa dyshim viktimat e trafikimit pritet të jenë ndër përfituesit kryesorë të kornizës së paraqitur ligjore. Kapitulli VI i Ligjit Nr. 04/L-218 "Për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit", dhe në veçanti nenet 42 dhe 43, adresojnë drejtpërdrejt nevojën

për kompensimin e shtetit për viktimat e trafikimit, dhe fëmijët, të cilët nuk mund të marrin kompensim të plotë nga kryerësit e krimeve, sepse nuk ishte e mundur ose për shkak se kryerësit e krimeve për çfarëdo arsye nuk u identifikuan, nuk janë ndjekur penalisht ose nuk u dënuan.

Jo vetëm që të drejtat e lartpërmendura janë të njohura plotësisht, por shteti gjithashtu pranon përgjegjësinë e tij për të krijuar një Komision i cili mund të përballojë këto kërkesa dhe gjithashtu të rregullojë çështjet thelbësore dhe procedurale të bashkangjitura me pranimin, dhënien dhe mohimin e kërkesave të tilla (neni 42, § 7, 8 & 9).

Mund të thuhet se dispozitat e lartpërmendura janë ndër forcat shtytëse që çuan në hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 05 / L-036 dhe UA (QRK) Nr. 01 dhe Nr. 2/2017.

Në shikim të parë dhe në parim, dispozitat e përfshira në Ligjin Nr. 05/L-036 dhe UA (QRK) Nr. 01 dhe Nr. 2/2017 duket se janë në përputhje me kërkesat e Kapitullit VI të Ligjit Nr. 04/L-218: "Kompensimi shtetëror parashikohet për dëmin material, emocional dhe fizik të shkaktuar ndaj viktimave të trafikimit, të rriturit, fëmijët dhe shtetasit jo-Kosovarë". Komisioni i Kompensimit të Viktimave të Krimit të Nenit 23 Ligji Nr. 05/L-036 është në përputhje me atë që është sugjeruar në Nenin 42, § 7 & 8 të Ligjit Nr. 04/L-218. Akti nënligjor për kompetencat dhe procedurat e tij është lëshuar (UA (QRK) Nr. 01/2017). Gjithashtu, Neni 11 nën paragrafi 1.1 përcakton qartë se viktimat mund të kërkojnë kompensim edhe nëse kryesi nuk është i njohur ose në ndonjë mënyrë nuk është sjellë kurrë para drejtësisë. Së fundmi, dispozitat e Kapitullit V të Ligjit Nr. 05/L-036 lehtësojnë dhënien e kompensimit viktimave të huaja të trafikimit.

Megjithatë, në praktikë, mund të lindin një sërë çështjesh procedurale që mund të ndikojnë në një masë të drejtën e viktimave të trafikimit për të kërkuar kompensim.

Tashmë është nënkuptuar në seksionin 1.2 që sipas Nenit 9 § 1 të Ligjit Nr. 05/L-036 aplikuesit për qasje të menjëhershme në kompensim nuk mund të paraqesin një aplikacion të tillë para se të kalojnë tre muaj nga zbulimi ose raportimi i krimit. Në mënyrë efektive, afati në këto raste reduktohet në 3 muaj dhe nuk fillon përpara afatit të përcaktuar në nenin. 9, §1. Është përkrahur se në shumë raste të viktimave të trafikimit, periudha e përmendur mund të jetë e papërshtatshme.

Kjo konsideratë ngre një çështje më gjenerale: shpesh është e nevojshme të ofrohet siguria e viktimave të trafikimit, veçanërisht kur autorët e krimeve të tilla nuk janë kapur (Neni 19, Ligji Nr. 04/L-218). Për më tepër, viktimat mund të jenë në mëdyshje për të siguruar të dhënat e tyre të plota personale në Komisionin për Kompensimin e Viktimave të Krimit përmes një aplikacioni, veçanërisht kur ata kuptojnë se ato duhet të arkivohen dhe procesohen nga zyrtarë të tjerë publikë.

Gjithashtu, viktimat e trafikimit kanë të drejtën për një periudhë reflektimi, e cila mund të zgjasë deri në 90 ditë (Neni 20 §2.9 i Ligjit Nr.04/L-218). Gjatë periudhës së reflektimit, viktimat, dhe sidomos fëmijët dhe kujdestarët e tyre ligjorë, mund të vendosin nëse do të bashkëpunojnë me autoritetet (Neni 38, pika 6, Ligji nr. 04/L-218). Kështu, parakushti kryesor për qasje të menjëhershme në

kompensim, bashkëpunimi i arsyeshëm (Neni 9, §2, Ligji nr. 05/L-036), gjithashtu do të duhej, në disa raste, të krijohet brenda periudhës së shkurtër të mbetur.

Në të gjitha skenarët e lartpërmendura, mund të sakrifkohet e drejta e kërkesës për qasje të menjëhershme në kompensim, pra në rastet kur ajo ekziston. Megjithatë, Neni 31 §4 i Ligjit Nr. 05/L-036 siguron një bazë ligjore për mbijetesën e kërkesës bazë të kompensimit.

Në praktikë, një periudhë e zgjatur e pamundësisë për të kërkuar dëmshpërblim për shkak të sigurisë ose konsideratave të tjera mund të interpretohet nga viktimat e trafikimit se ata duhet të zgjedhin midis të drejtës së tyre për sigurinë ose të drejtën e tyre për kompensim. Për fat të keq, për shkak të mungesës së rasteve të përpunuara plotësisht në këtë pikë, nuk mund të nxirren prova empirike në lidhje me ekzistencën dhe funksionet e masave mbrojtëse procedurale dhe substanciale ose mungesës së tyre.

Është e rëndësishme që Ligji Nr. 05/L-036. dhe UA (QRK) Nr. 01 & Nr. 2/2017 të shqyrtohet në këtë fushë. Brengat e mundshme të viktimave të trafikimit duhet të shprehen dhe kur të bazohen në baza bindëse, ato duhet të adresohen. Mendimi i Koordinatorit Nacional Anti-Trafikim dhe Autoritetit Nacional kundër Trafikimit në këtë procedurë mund të jetë i dobishëm. Duke u marrë me një sërë rastesh të trafikimit dhe duke qenë në posedim të përvojave të rëndësishme në terren, autoritetet e lartpërmendura mund të japin të dhëna të vlefshme dhe sugjerime lidhur me masat mbrojtëse procedurale dhe substanciale. Një rishikim i tillë i legjislacionit dhe procedurave ekzistuese mund të lehtësojë (Ministrinë e Drejtësisë dhe Komisionin) për të bërë qasjen në kompensim më të lehtë për viktimat e trafikimit

3. Aspektet vepruese dhe Rekomandimet

Përveç aspekteve ligjore të detajuara më lartë, analiza funksionale ka sjellë edhe një numër fushash vepruese që kanë nevojë për racionalizim të mëtejshëm. Seksioni në vijim detajon këto aspekte dhe ofron rekomandime përkatëse për funksionalizimin e mëtejshëm të funksionit të Komisionit.

3.1 Procedurat Standarde të Veprimit

Pasiqë Programi i Kompensimit të Viktimave u bë funksional vetëm kohët e fundit, funksioni i Komisionit mund të përfitonte nga miratimi i një Procedure Standarde të Veprimit. Analiza funksionale në pjesën e parë të raportit aktual potencialisht mund të kontribuojë drejt këtij qëllimi. Përveç kësaj, në përputhje me hapat proceduralë të paraqitur në seksionin 7 të Manualit të zhvilluar më herët nga Projekti (shih Manualin D.1.4.1), krijimi i Procedurave Standarde të Veprimit që përshkruajnë mënyrën dhe afatin kohorë se si trajtohet çdo aplikim - nga momenti i marrjes deri në momentin e vendimit përfundimtar do të mund të rrisë efektivitetin e veprimeve të Komisionit në drejtim të menaxhimit të kohës dhe ngarkesës së punës.

Analiza funksionale dhe hapat përkatës proceduralë për vlerësimin e kërkesave në seksionin 7 të Manualit janë zhvilluar në bazë të veprimeve të detajuara në ligjin përkatës dhe UA që deri më tani janë publikuar. Megjithatë, duke marrë parasysh ngarkesën e parashikuar të punës së Komisionit, kompleksitetin e procesit të aplikimit për aplikuesit dhe themelimin rishtas të Programit të Kompensimit të Viktimave, rekomandohet përfshirja e një hapi shtesë në procesin e parashikuar.

Më konkretisht, është propozuar si një praktikë e mirë për menaxhimin e ngarkesës së punës për të përfshirë një proces të 'Shqyrtimit Fillestar' përpara 'Shqyrtimit Preliminar' në hapin 4. Gjatë kësaj faze, dhe përpara se një aplikim të përcillet për vlerësim tek Komisioni, do të mund të shqyrtohej në kuptim të plotësimin dhe të gjithëpërfshirjes, duke përcaktuar nëse të gjitha informatat e kërkuara dhe dokumentacioni mbështetës janë siguruar me rregull. Në rastet kur aplikimet janë të paplota ose jopërfshirëse, i shtohet kërkuarit afati i fundit për përmirësim/plotësim, në përputhje me Nenin 33, § 2 & 3, të Ligjit Nr. 05/L-036, dhe vetëm pas skadimit të këtij afati ose përmirësimin të plotë të mangësive, aplikimi i dërgohet Komisionit për vlerësim.

Procesi i "Shqyrtimit Fillestar" mund të kryhet potencialisht nga personeli administrativ, duke strukturuar numrin e aplikacioneve dhe duke kursyer kohën e Komisionit nga shqyrtimi i aplikacioneve jo të plota, të cilat parashihet të jenë mjaft të shpeshta, sidomos gjatë periudhës së parë të zbatimit të Programit për Kompensimin e Viktimave.

3.2 Sistematizimi i vendim-marrjes

Një aspekt sfidues, sidomos gjatë muajve të parë të funksionimit të Komisionit, pritet të jetë standardizimi i shpenzimeve dhe krahasueshmëria e kompensimeve të dhëna në raste të ngjashme. Përveç kësaj, siç parashihet me Nenin 11, pika 5, të UA (QRK) Nr. 01/2017 Komisioni duhet të krijojë sisteme për vlerësimin e përshtatshmërisë së kompensimit në rastet e krimeve që nuk janë të parapara me ligj e të cilat Komisioni i konsideron të kompensueshme. Për këtë qëllim, një rishikim sistematik i rasteve që potencialisht mund të kenë merita për kompensim në nivele dhe gradime të ndryshme mund të jenë shumë të dobishme.

Përveç kësaj, duke marrë parasysh kufizimet potenciale të buxhetit, rekomandohet që së bashku me kërkesat për mbajtjen e regjistrave dhe të dhënave të kërkuara për raportimin vjetor financiar të Komisionit në Ministrinë e Financave mbi numri i aplikuesve dhe shumat e dhëna të kompensimeve, Komisioni të krijojë një bazë të digjitalizuar për të dhënat statistikore që përfshijnë të gjitha informatat e kërkuara të lartpërmendura përveç atyre të dhënave mbi natyrën e krimeve, dëmeve, lëndimeve dhe shpenzimeve mjekësore.

Përfshirja e të gjithë variablave përkatës në një bazë të dhënash të unifikuar dhe të koduar mirë që nga fillimi i funksionimit të Programit të Kompensimit të Viktimave do të mundësojë përfaqësim statistikor sistematik dhe analiza të bazuara në dëshmi të punës së Komisionit për intervale fikse. Duke lejuar kështu monitorim të rregullt të veprimeve të tij dhe dhënien e mundësive për ndërhyrje të hershme dhe përmirësime, nëse janë të nevojshme. Idealisht, autoritetet së shpejti do

të ishin në gjendje të hulumtojnë aspektet teknike dhe financiare të ndërmarrjeve dhe në përputhje me këtë të vendosin një plan përkatës që është në përputhje me kufizimet ekzistuese buxhetore dhe fondet e parashikueshme të Programit.

3.3 Mbrojtja e të dhënave dhe sistemi i ruajtjes së regjistrave

Është e qartë se përpunimi dhe regjistrimi i të dhënave të ndjeshme personale në shkallë të konsiderueshme parashikohet gjatë gjithë Programit të Kompensimit të Viktimave. UA (QRK) Nr. 02/2017 parasheh një process specifik, formën dhe mënyrën e mbajtjes së shënimeve. Prandaj rekomandohet që në këtë fazë të ketë prioritet vendosja e një sistemi të duhur të regjistrimeve sipas dispozitave përkatëse.

Duhet të theksohet se procesimi i tillë i të dhënave ka të bëjë me të drejtat themelore të viktimave, dëshmitarëve, ekspertëve dhe autorëve të krimit (të supozuar) dhe, sipas rrethana, mund të ngrehin shqetësime lidhur me legjitimitetin e disa prej aspekteve të tij. Kontrollat e rregullta të konformitetit me Ligjin e aplikueshëm për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, së bashku me instrukcionet dhe udhëzimet, mund të sigurohen nga Agjencia Nationale për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Prandaj, Ministria e Drejtësisë dhe Komisioni mund të përfitojnë nga bashkëpunimi dhe konsultimi i qëndrueshëm me Agjencinë e lartpërmendur. Një bashkëpunim i tillë duhet gjithashtu të jetë i dobishëm kur të ndodhin çështje të cilat nuk janë zgjidhur ende, të tilla si periudhat minimale dhe maksimale të pranueshme të mbajtjes së të dhënave të cilat mbahen në regjistrat e përcaktuar me UA (QRK) Nr. 02/2017.

3.4 Pengesat potenciale

Disa pengesa potenciale, si në buxhet ashtu edhe në kohë, që janë identifikuar dhe duhet të merren në konsideratë gjatë veprimeve të Komisionit, në afatet e parapara me ligj dhe buxhetin në dispozicion, përfshijnë përkthimin, lëshimin dhe rishpalljen e dokumenteve në rastet e mëposhtme :

- Në rastet e një viktime të huaj të trafikimit, dokumentet janë të pranueshme në çdo gjuhë dhe Ministria e Drejtësisë merr përsipër obligimin e përkthimit të dokumenteve (Neni 24, pika 3, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Shpenzimet për lëshimin e dokumenteve të cilat konstatohet nga Komisioni se janë të rëndësishme për përcaktimin e llojit dhe shkallës së dëmeve mund të mbulohen si shpenzime procedurale për paraqitjen e aplikacionit (Neni 24, §1, UA (QRK) Nr. 01 / 2017).
- Shpenzimet për lëshimin e dokumentacionit shtesë të kërkuar nga Komisioni në të gjitha rastet mbulohen nga Ministria e Drejtësisë (Neni 24, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Rilëshimi i dokumenteve që janë humbur, dëmtuar ose shkatërruar, do të bëhet me pagesën e Ministrisë së Drejtësisë (Neni 6 UA (QRK) NR 02/2017)

- Ministria e Drejtësisë mbulon shpenzimet e nevojshme të përkthimit të dokumenteve në nivel nacional (Neni 26, 6, UA (QRK) Nr 01/2017) dhe situata të huaja ndërkufitare (Neni 27, 8, UA (QRK) Nr 01/2017)

3.5 Forma e aplikimit

Sipas Ligjit Nr. 05/L-036, personat e tretë mund të jenë edhe kërkues për kompensim, pavarësisht se nuk janë viktime të drejtpërdrejta të krimeve të përfshira në Nenin 6, si në rastet e mëposhtme:

- Kompensimi për shqetësim të shëndetit mendor për shkak të humbjes së një të afërmi të ngushtë
- Kompensimi për humbjen e mirëqenies për shkak të humbjes së një kujdestari kryesor.
- Kompensimi për shpenzimet e varrimit të një viktime të krimeve të përmendura

Megjithatë, formulari i aplikimit nuk bën referencë të drejtpërdrejtë për ato raste, përveç një referimi të tërthortë në pjesën e 7 të aplikacionit. Pjesa 2 e formularit të aplikacionit aplikohet për personin e tretë që aplikon *në emër të viktimave dhe jo në të drejtën e tyre*. Pjesa 2 e udhëzimeve për plotësimin e aplikacionit parashikon që palët e treta duhet të plotësojnë informatat e tyre në pjesën 2 të aplikacionit. Sidoqoftë, në këtë pjesë të aplikimit nuk është trajtuar çështja e kërkuesit shprehimisht duke deklaruar nëse ai/ajo është duke kërkuar kompensim në të drejtën e tij ose në emër të një viktime krimi (ose në të dyja kapacitetet). Në këtë drejtim, mund të jetë e dobishme të shqyrtohet formulari i aplikimit nga këndi i një personi të tretë, i cili sipas Ligjit Nr. 05/L-036 mund të ketë kërkesë për kompensim.

3.6 Ofrimi i informatave për aplikuesit

E drejta e viktimave për informata duhet të konsiderohet si një parim udhëzues gjatë të gjitha veprimeve të Programit të Kompensimit të Viktimave. Neni 10, §1, i UA (QRK) Nr. 01/2017 qartazi thekson se viktime 'do të pajiset me informata të besueshme në çdo kohë'.

Në përputhje me ato që u përmendën më sipër, si dhe kërkesën për të ofruar udhëzime të përgjithshme për aplikuesin, duke përfshirë informatat për mënyrën e plotësimit të aplikacionit dhe dokumentacionit përkatës mbështetës (Neni 28, pika 3, ligji nr. 05/L-036) udhëzimet e hollësishme mbi plotësimin e aplikacionit, dokumentacionit të kërkuar mbështetës, si dhe informatat e përgjithshme për paraqitësit e kërkesave janë bërë të disponueshme përmes faqes së internetit të Ministrisë së Drejtësisë.

Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se procesi është krijuar vetëm në kohët e fundit, kompleksiteti i legjislacionit në fuqi dhe mundësia që jo të gjithë aplikuesit të kenë mundësi të kërkojnë ndihmë gjatë procesit të aplikimit nga avokatët e viktimave ose organizatat që ofrojnë asistencë ligjore falas do të konsiderohej një praktikë e mirë jo vetëm që thjesht të informohen palët e interesuara për të drejtat e tyre, por gjithashtu të sigurohen informata të hollësishme, të qarta dhe

lehtësisht të kuptueshme për ushtrimin e këtyre të drejtave. Shembulli i procesit të fillimit të një ankese administrative kundër vendimit të Komisionit (Neni 34, pika 7, ligji nr. 05/L-036) është një nga procedurat që rekomandohet të sqarohet për aplikuesit (shih gjithashtu pjesën 2.1.7).

3.7 Kooperimi institucional dhe dukshmëria e Programit

Në sektorë të ndryshëm të veprimeve të Komisionit nevojitet shkëmbimi i informatave dhe bashkëpunimi me autoritetet përkatëse, si Policia, zyrtarët e përfshirë në procesin penal, autoritetet shtetërore, autoritetet e pavarura (p.sh. Agjencia Nationale për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) autoritetet e bashkësive dhe organeve lokale vetëqeverisëse, përveç bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë për llogaritjen e dëmeve (për shembull, Neni 12, pika 3, Ligji Nr. 05/L-036). Prandaj, zhvillimi i sinergjive me institucionet e lartpërmendura për shkëmbimin e informatave dhe të dhënave në kohën e duhur konsiderohet vendimtar për funksionimin e Programit të Kompensimit të Viktimave.

Paralelisht me ato më sipër, zhvillimi i sinergjive mund të përdoret për të rritur dukshmërinë e Programit të Kompensimit të Viktimave dhe sensibilizimin e palëve të interesit, autoriteteve dhe institucioneve për të promovuar Programin, por gjithashtu për të informuar viktimat dhe parashtruesit e mundshëm të kërkesave për të drejtën e tyre për kompensim. Sidomos Policia, si pika e parë e kontaktit me viktimat, Avokatët e Viktimave dhe Organizatat Mbështetëse të Viktimave.

Vërejtjet & Rekomandimet konkluduese

Një observim ndërsektorial që rrjedh nga raporti aktual i analizës është se gjatë disa muajve të fundit janë bërë hapa të rëndësishëm drejt avancimit të veprimeve të Programit të Kompensimit të Viktimave. Duke marrë parasysh gjetjet e pjesës së dytë të këtij raporti, disa fusha që mund të përfitojnë nga racionalizimi i mëtejshëm dhe që do të rrisin ndjeshëm kapacitetin veprues të Komisionit dhe do të siguronin qëndrueshmërinë e Programit, janë përmbledhur më poshtë:

- Sugjerohet që autoritetet të konsiderojnë qartësimin e të drejtës së aplikantëve për një aplikim të ri dhe/ose rishqyrtimin e aplikacionit në rastet e dëshmime të reja mbështetëse ose dokumenteve që bëhen të disponueshme pas dhënies së një vendimi të Komisionit ose pas skadimit të afatit kohor të aplikueshëm për përmirësimin e një aplikacioni jo të plotë (seksioni 1.1).
- Rekomandohet që autoritetet të marrin parasysh qartësimin e Nenit. 14 § 3 të UA (QRK) Nr. 01/2017 lidhur me shumën maksimale të kompensimit të siguruar për dhimbje ose dëmtime fizike (neni 1.3)
- Propozohet shqyrtimi i Nenit 20 UA (QRK) Nr. 01/2017 mbi trajtimin e aplikacioneve për kompensimin për humbjen e një të afërmi të ngushtë për të qartësuar nëse nenet 15 dhe 16 janë gjithashtu të aplikueshme në raste të tilla (neni 1.4).

- Sugjerohet se mund të jetë e dobishme një rishikim i Nenet 16 Ligji Nr. 05/L-036 dhe Neni 15 § 5, UA (QRK) Nr. 01/2017 lidhur me llogaritjen e shpenzimeve mjekësore (seksioni 1.5).
- Rekomandohet që autoritetet mund të përfitojnë nga dhënia e udhëzimeve për interpretimin e Nenet 20, §1, Ligji Nr. 05/L-036 lidhur me rrethanat që ndikojnë në kompensimin e dhënë (Neni 1.6).
- Propozohet sqarimi i afateve të zbatueshme në rastet ndërkufitare (seksioni 2.1.8).
- Rekomandohet që Ligji Nr. 05/L-036 dhe UA (QRK) Nr. 01 & Nr 2/2017 të shqyrtohen nga afër në fushën e qasjes së viktimave të trafikimit në kompensim, veçanërisht në lidhje me afatet e aplikueshme (Nenet 1.2 & 2.).
- Krijimi i Procedurave Standarde të Veprimit dhe procesi për shqyrtimin fillestar të aplikacioneve, në kuptim të plotësisht dhe të përfshirjes, përpara se të përcillen aplikacionet në Komision për shqyrtim mund të jenë të dobishme për punën e Komisionit. Për këtë qëllim, analiza e aspekteve procedurale dhe operacionale të aplikacioneve të para që do të shqyrtohen nga Komisioni mund të ofrojnë njohuri të dobishme. (seksioni 3.1).
- Propozohen si praktika të mira - sistematizimi i vlerësimit të ankesave në lidhje me krimet që nuk janë parashikuar nga Ligji, sistemimi dhe digjitalizimi i grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave (seksioni 3.2).
- Një praktikë e mirë e rekomanduar do të ishte krijimi i një sistemi të përshtatshëm të mbajtjes së shënimeve në përputhje me Ligjin e zbatueshëm për Mbrotjtjen e të Dhënave dhe në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Nacionale për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale (seksioni 3.3).
- Propozohet që ndikimi i përkthimit, lëshimit dhe rilëshimit të dokumenteve në buxhet dhe afatet kohore të punës së Komisionit të merren në konsideratë nga autoritetet (seksioni 3.4).
- Sugjerohet rishikimi i Formularit të Aplikimit nga këndi i një pale të tretë që do të aplikonte për kompensim në të drejtën e tij dhe kjo mund të dëshmojë si e dobishme për aplikuesit e tillë (seksioni 3.5).
- Rekomandohet si një praktikë e mirë – dhënia e informatave të hollësishme, të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme për aplikantët se si të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas ligjit - veçanërisht në proceset siç është e drejta për të inicuar një ankesë administrative kundër një vendimi të Komisionit – (seksioni 3.6), dhe
- Propozohet që zhvillimi i mëtejshëm i sinergjive dhe forcimi i bashkëpunimit institucional potencialisht të kontribuojnë në shkëmbimin efikas të informative dhe bashkëpunimit midis autoriteteve kompetente, si dhe rritjen e dukshmërisë dhe qasjen e viktimës në program (seksioni 3.7).

Rekomandimet për ofrimin e përkrahjes për Komisionin dhe Sekretariatit

Bazuar në planin fillestar të formuluar gjatë fazës fillestare të projektit (Janar-Prill 2017) sipas reagimeve të palëve relevante të interesit, hapi tjetër pas analizës aktuale ishte sigurimi i mbështetjes për themelimin e Sekretariatit, nëpërmjet elaborimit të një propozimi për organizimin dhe personelin e tij dhe hartimin e dokumenteve të nevojshme rregullative për themelimin e saj. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se Sekretariati është themeluar dhe në ndërkohë anëtarët e tij janë emëruar, është propozuar alternativisht si hap i ardhshëm ofrimi i mbështetjes teknike për Sekretariatit për t'u bërë plotësisht funksional. Rezultatet relevante do të përshkruhen në një raport përfundimtar përmbledhës mbi ofrimin e mbështetjes teknike, duke përfshirë një analizë fillestare të Sekretariatit të themeluar kohët e fundit.

Parashikohet që krijimi i Sekretariatit do të kontribuojë ndjeshëm në drejtim të funksionimit efikas dhe të suksesshëm të Programit. Analiza e tanishme tregon se Sekretariati potencialisht mund të mbështesë punimet e Komisionit në fushat e mëposhtme:

- Pranimi i aplikacioneve
- Mbajtja e shënimeve, përditësimi dhe mirëmbajtja
- Shqyrtimi fillestar i aplikacioneve
- Dorëzimi i kërkesave për informata shitesë
- Ofrimi i informatave për aplikuesit
- Komunikimi me autoritetet e tjera
- Komunikimi me autoritetet e huaja në situatat ndër-kufitare
- Përkthimi i dokumenteve
- Të dhënat financiare dhe raportimi
- Nevojat IT dhe digjitalizimi i regjistrave.

Sidoqoftë vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet specifikave të saj vepruese. Për këtë qëllim dhe në përputhje me kornizën e veprimit të projektit, propozohen disa fusha kyçe për ofrimin e mbështetjes, mentorimit ose ngritjes së kapaciteteve nga Ekipi i Projektit tek Komisioni dhe Sekretariati, duke përfshirë:

- Njohuri themelore dhe të avancuara mbi të drejtat e viktimave të trafikimit
- Njohuri themelore dhe të avancuara mbi anti-trafikimin
- Zbatimi i ligjit në rastet e të rriturve dhe fëmijëve viktimë të trafikimit
- Korniza e vlerësimit të veprimit në rastet e të rriturve dhe fëmijëve viktimë të trafikimit
- Pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit në trajnimet e përbashkëta të planifikuara të projektit
- Trajnimi për formularët e aplikimit
- Mbështetje në zhvillimin e Procedurave Standarde të Veprimit, Procedurave të Përmirësimit, Protokolleve të Veprimit dhe Listave të Kontrollit në lidhje me aspektet vepruese dhe funksionet ditore të Komisionit dhe Sekretariatit, me qëllim të avancimit të zbatimit efikas dhe uniform të kornizës aktuale ligjore.